

# ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK

---



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË**

**OFRIMI I SHËRBIMEVE eKIOSK NË NJ.A.**



**Versioni 1.0  
Data 31-05-2017**

## FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

### Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
31.05.2017		1.0	

### NËNSHKRIMET MIRATUESE

#### Të dhënat e personit të Kontaktit:

<Në tabelën e mëposhtme duhet të paraqitet informacioni në lidhje me zyrtarin që përgatit specifikimet teknike.>



## Permbledhja

Permbledhja .....	3
1. HYRJE.....	5
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues .....	5
1.2. Historiku .....	5
1.3. Situata Aktuale në Sektor .....	5
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA .....	5
2.1. Objektivi i Përgjithshëm .....	5
2.2. Qëllimi .....	6
2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori.....	6
3. SUPOZIMET DHE RISQET .....	7
3.1. Supozimet e Projektit .....	7
3.2. Risqet .....	7
4. QËLLIMI I PUNËS.....	7
4.1. Të Përgjithshme .....	7
4.1.1. Përshkrimi i detyrës .....	8
4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet.....	8
4.1.3. Grupet e synuara.....	8
4.1.4. Siguria e sistemit .....	8
4.2. Detyrat specifike.....	10
5. LOGJISTIKA DHE KOHA .....	13
5.1. Vendndodhja .....	13
5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave .....	14
6. RAPORTIMI .....	14
6.1. Kërkesat e Raportimin.....	14
6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve .....	14
7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA .....	14
8. GARANCIA .....	14
9. MIRËMBAJTJA.....	15
10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT .....	15
11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT .....	16
12. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT .....	17
13. KËRKESAT FUNKSIONALE .....	17
13.1. Funksionalitete dhe Bllokskema.....	19
13.2. Karakteristikat teknike te platformes per kioska elektronike .....	20

13.3. Profilizimi i përdoruesve .....	20
13.4. Raporte.....	21
14. KËRKESAT TEKNIKE .....	21
14.1. Implikimet teknike që lidhen me zgjidhjen e propozuar: .....	21
14.3. Kërkesat harduerike për furnizim .....	21
14.3. Zgjerimi për të ardhmen .....	23
14.4. Kërkesa për dokumentimin e planit dhe implementimit të projektit .....	23
HOSTUESE SOFTWARE .....	23



## 1. HYRJE

---

### 1.1.Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tiranë

### 1.2.Historiku

Kërkesat për performancë më të lartë dhe pritshmëritë që Bashkia Tiranë të arrijë rezultate më cilësore në lidhje me ofrimin e shërbimeve të gjendjes civile ndaj qytetarëve të saj, për të ardhur në ndihmë të tyre dhe për të lehtësuar punën e stafit të zyrave të gjendjeve civile, lind nevoja e një projekti që synon të sigurojë Implementimin e kioskave elektronike, të cilat do të jenë të lidhura me sistemin elektronik të gjendjes civile, nga ku qytetarët mund të paraqiten dhe të pajisen në kohë reale me dokumentat elektronike: certifikatë lindje, certifikatë martesore, certifikatë shtetësie, certifikatë vendbanimi.

### 1.3.Situata Aktuale në Sektor

Aktualisht, Bashkia Tiranë, si bashkia më e madhe në vend nga e cila varen 24 Njësi Administrative me rreth 860 mijë banorë gjithsej, përjeton vështirësi në menaxhimin e një sërë procesesh administrative të nevojshme në shërbimin ndaj qytetarëve për pajisjen me dokumentat e gjendjes civile. Prej disa vitesh, pranë zyrave të gjendjeve civile është implementuar një sistem elektronik i specializuar për regjistrimin dhe printout-in elektronik të dokumentave të sipërcituar. Si rrjedhojë e kërkesave mjaft të shpeshta për pajisjen me dokumenta të kësaj natyre, shpesh herë krijohen rradhë pranë sporteleve të zyrave të gjendjeve civile, të alokuara pranë njësive administrative, duke krijuar kështu vonesa të konsiderueshme në marrjen e shërbimeve nga ana e qytetarëve.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

---

### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit nga i cili kjo kontratë do të jetë pjesë, është si vijon:

- Implementimi i kioskave vetshërbyese të cilat do të iu mundësojnë qytetarëve shërbim 24 orësh me shërbimet e gjendjes civile (certifikatat e gjendjes civile).

- Ndërtimi i një sistemi softuerik i cili do të instalohet dhe do të mundësojë shërbimin për qytetarët.
- Zhvillimi i një databaze për ruajtjen e të dhënave dhe statistikave të aplikantëve në pikat e vetshërbimit.
- Ndërlidhja me sistemin e gjendjes civile dhe shkëmbim i të dhënave në kohë reale me sistemin elektronik të gjendjes civile.
- Zvogëlimi i rradhëve të pritjes dhe përmirësimi i dukshëm i kualitetit të shërbimeve ndaj qytetarit.
- Mundësia e dërgimit të ankesave dhe kërkesave në çdo kohë.

## 2.2. Qëllimi

Qëllimet e këtij projekti janë si më poshtë:

- Lehtësimi i procedurave dhe automatizimi i shërbimeve të gjendjes civile ku qytetarët në çdo kohë do të mund të kryejnë shërbimet e veta siç është furnizimi me certifikata të gjendjes civile.
- Ofrimi i mundësisë për qytetarët që në formë elektronike gjatë gjithë kohës të kenë mundësi të dërgojnë kërkesë ose ankesë në Bashki.
- Sigurimi i një sistemi monitorues dhe menaxhues i shërbimeve të konsumuara nga ana e qytetarëve në pikat për vetshërbim.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

## 2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga Kontraktori në kuadër të këtij projekti do të jenë:

- Kontraktori duhet të konfirmojë bashkarisht me Bashkinë e Tiranës funksionet që do përmbajë sistemi i ngritur bazuar në objektivat e projektit;
- Kontraktori, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës duhet të përgatisë module trajnimi dhe të zhvillojë trajnimin e punonjësve në lidhje me përdorimin e sistemit menaxhues dhe mirëmbajtjen e pikave të vetshërbimit;
- Përfundimi i instalimit të infrastrukturës software të sistemit pranë Bashkisë Tiranë, përcaktimi i procedurave të nevojshme për mirëmbajtje.

### 3. SUPOZIMET DHE RISQET

---

#### 3.1. Supozimet e Projektit

Bashkia Tiranë supozon që sistemi menaxhues i ekioskave për vetshërbim bashkë me databazën për ruajtje lokale dhe infrastruktura komunikuese do të instalohen në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Tiranë.

Do të ngrihet një grup pune i posaçëm të cilët do të jenë përgjegjës për të gjitha fazat e zhvillimit të projektit.

#### 3.2. Rrisqet

Duke u bazuar në nevojën dhe në trendin e sotëm të zgjidhjeve teknologjike, si çdo projekt i këtyre përmasave, ekzistojnë një sërë rrisqesh për implementimin dhe përfundimin me sukses të këtij projekti. Disa prej tyre renditen si më poshtë:

- Detaje ende të papërcaktuara të funksionimit të Bashkisë dhe njësive administrative të reja;
- Vështirësi në furnizimin me rrjet dhe rrymë elektrike;
- Vështirësi teknike në pjesën infrastrukturës (rrjet, server);
- Mos-sigurimi i një strukture për instalimin dhe administrimin e sistemit dhe databazës.

### 4. QËLLIMI I PUNËS

---

#### 4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është e listuar më poshtë:

- Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 “për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”
- Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 për pronat e paluajtshme të shtetit
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore
- VKM nr.378, date 12.8.1999 per kalimin e se drejtes te perfaqesuesit te pronarit per disa objekte prone publike, organeve te qeverisjes vendore
- VKM nr. 500, date 14.8.2001 per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore
- Udhëzimi Nr. 30, Ministria e Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”
- Vendimi i këshillit të Ministratve nr.332, datë 17.03.2010, për “Përcaktimin e formës, elementëve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që lëshohen nga Shërbimi i Gjendjes Civile
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

- Ligji n.73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"
- Urdhëri i MB Nr.42, datë 31.1.2011 "Për specifikimet teknike të akteve, të certifikatave dhe procesverbaleve që plotëson dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile".

#### **4.1.1. Përshkrimi i detyrës**

Bashkia e Tiranës sikurse një pjesë e mirë e bashkive me numër të madh të banorëve përballet me rradhë të pritjes për furnizimin me dokumente të gjendjes civile. Kjo ndodh për shkak të fluksit të madh e sidomos në periudhën e verës ose në prag të festave të ndryshme kur rritet edhe numri i emigrantëve që shfrytëzojnë pushimin për të përfunduar punët e ndryshme në administratë dhe gjendje civile. Përballimi i këtyre kërkesave është i vështirë. Shtimi i punonjësve të administratës, përveç që ngarkon buxhetin shtetëror, nuk është garanci e mjaftueshme për përmirësim kualiteti.

Në mënyrë që sado pak të evitohet një gjendje e tillë Bashkia e Tiranës është e përkushtuar në gjetjen e një zgjidhjeje teknologjike për lehtësimin e gjithë këtij procesi dhe për këtë qëllim synon të zhvillojë projektin e ekioskave vetshërbyese.

eKioska paraqet një zgjidhje teknologjike me konstruksion metalik dhe që ofron akses nga jashtë për qytetarët. Aksesit ofrohet përmes ekranit të ndjeshëm në prekje. Të ngjashme me bankomatët e bankave të ndryshme, ekioskat do vendosen në hapësira të hapura ku ofrohet akses për qytetarët gjatë gjithë kohës. Qytetarët do të pajisen me broshura për përdorim por njëkohësisht instruksionet do të përmbahen edhe në programin softuerik të ekioskës. Qytetarët do të identifikohen përmes letërnjoftimit i cili do të skanohet nga pajisja përkatëse brenda ekioskës. Pas identifikimit, programi në kohë reale dhe në mënyrë automatike do të shkëmbejë të dhënat me sistemin elektronik të regjistrimit civil ku do të merren të gjitha të dhënat për çertifikatat e disponueshme të qytetarit. Pasi përzgjidhet lloji i çertifikatës dhe pasi kryhet pagesa, ekioska shtyp çertifikatën përkatëse dhe dëshminë e pagesës.

#### **4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet**

Bashkia Tiranë

#### **4.1.3. Grupet e synuara**

- Stafi i Bashkisë Tiranë
- Publiku (qytetarët)

#### **4.1.4. Siguria e sistemit**

eKioska dhe programet softuerike shoqëruese të saj duhet të ofrojnë nivel të lartë të sigurisë. Niveli i sigurisë duhet të garantohet nga aspekti fizik dhe nga ai i të dhënave. Aplikacionet duhet të sigurojnë shtyllat e sigurisë:

- Konfidencialitet – në kuptimin e asaj që të dhënat që cilësohen si konfidenciale dhe të ndjeshme duhet të ruhen në formë të enkriptuar në databazë. Po ashtu komunikimi duhet të bëhet në formë të sigurtë.
- Integriteti – në kuptimin e asaj që të dhënat duhet të jenë të besueshme dhe që ato të jenë të besueshme duhet të garantohet që kanë integritet të plotë dhe që askush nuk ka mundësi



ndërhyrjeje në to.

- Autentikimi – në kuptimin e asaj që aksesimi duhet të lejohet vetëm për ata persona që kanë autorizim për t'u aksesuar duke bërë paraprakisht prezantimin apo autentikimin me aplikacion. Standardet e fundit dhe më të njohura të sigurisë duhet të ofrohen në sistem. Ndër të tjera:

- Duhet të jetë e mundur që autentikimi i përdoruesve të realizohet nëpërmjet kartës së identitetit në rastin e qytetarëve ose përmes përdorues (username) dhe fjalëkalim (password), si dhe protokollit të sigurtë të transmetimit për rastin e administratorëve;
- Duhet të ofrohet siguri e lartë në nivel databaze, ku të dhënat e rëndësishme dhe të ndjeshme duhet të ruhen si të enkriptuara ndërkohë pjesë të tyre edhe në metodën e njohur si “salted hash” ku procesi është njëdrejtimor (pa mundësi kthimi), siç është rasti me fjalëkalimet e përdoruesve. Në këtë rast as administratorët nuk duhet të kenë mundësi të shikimit por vetëm të resetimit. Komunikimi me bazën e të dhënave duhet të bëhet i centralizuar dhe nga një përdorues (sistemi) kredencialet e të cilit do të ruhen po ashtu si të enkriptuara në platformë.
- Sistemi që do jetë në shërbim të qytetarit do bëjë autentikimin përmes kartës së identitetit dhe pastaj komunikimi duhet të shkojë në formë të sigurtë. Aplikacioni i menaxhimit do të jetë i bazuar në llogari (Account based) dhe duhet të mundësojë identifikimin si dhe modulën për administrim të përdoruesve. Nëpërmjet këtij moduli do të mundësohet krijimi i përdoruesve të rinj dhe menaxhimi i atyre ekzistues. Ky modul do të jetë i aksesueshëm vetëm nga administratorët e sistemit dhe këta të fundit do të kenë mundësinë për krijimin dhe menaxhimin e të drejtave të çdo përdoruesi nëpërmjet implementimit të roleve, autorizimeve, të drejtave selektive mbi të dhënat e aplikimit, etj.

Kontraktori është i detyruar të zbatojë rregulloret e sigurisë të nxjerra nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Kompjuterike (ALCIRT). Niveli i kërkuar i sigurisë duhet të përcaktohet në përputhje me objektivat e sigurisë së informacionit nëpërmjet parametrave të integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë si më poshtë:

- Disponueshmëria D1, 90% (ndërprerja totale e lejueshme në një javë ~ 24 orë); vonesa e lejueshme e kohës së reagimit të kërkuar në pikun e ngarkesës - orë (1÷10);
- Integriteti II, ekzistenca e ndryshimeve apo dëmtimeve është e zbulueshme; verifikimi i saktësisë, integriteti dhe përditësimi i informacionit në raste të veçanta dhe sipas nevojës;
- Konfidencialiteti K0, informacioni publik: aksesimi i informacionit nuk është i kufizuar (p.sh. të gjithë personat e interesuar kanë të drejtë të lexojnë të dhënat); e drejta për të ndryshuar të dhënat përcaktohet nga kërkesat e integritetit.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit është bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input checked="" type="checkbox"/> K0	
<input checked="" type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input type="checkbox"/> D2	<input checked="" type="checkbox"/> I2	<input type="checkbox"/> K2	<input checked="" type="checkbox"/> M
<input type="checkbox"/> D3	<input type="checkbox"/> I3		<input type="checkbox"/> L

- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
- Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.
- Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

#### 4.2. Detyrat specifike

##### **FAZA I: Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proceseve**

- Konfirmimi i kërkesave kryesore të administrimit të funksionaliteteve të sistemit në bashkëpunim me stafin e Bashkisë Tiranë;
- Analizim dokumentash të gjendjes civile;
- Referime në kuadrin ligjor.
- Vlerësimi i të gjitha mundësive për zhvillimin e sistemit
- Përcaktimi i hapave të zhvillimit dhe afateve kohore të tyre
- Hartimi i diagramave mbi proceset bazike

##### **FAZA II: Zhvillimi i sistemeve, furnizimi i infrastrukturës hardware dhe instalimi i ekiokës**

- Ndërtimi/zhvillimi i sistemeve – aplikacionit për shfrytëzim nga qytetarët dhe aplikacionit për administrim.
- Hartimi i listës përfundimtare të instalimeve që duhen bërë në infrastrukturën dhe resurset harduerike të bashkisë.
- Furnizimi i infrastrukturës hardware.
- Dokumentimi i saktë dhe i plotë i mënyrës së komunikimit me web shërbime dhe me databazën qendrore.
- Testimi dhe integrimi i moduleve me tërësinë e komponentëve dhe të dhënave të sistemit.

- Përgatitja e mjedisit teknik për instalimin dhe testimin e sistemit.
- Përgatitja e mjedisit fizik për instalimin dhe testimin e kioskës.

### FAZA III: Testimi


- Definimi i rasteve të testimit
- Testimi i sistemit, dokumentimi i rezultateve të tij
- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre
- Ritestim i proceseve të ndryshuara.

### FAZA IV: Trajnimi

- Zhvillimi i trajnimeve për pjesën fizike dhe për pjesën teknike (si psh mbushja me fleta, administrimi i mbushjes me fleta).
- Suport në ndjekjen e praktikave reale.

### FAZA V: Mirëmbajtje

- Mirëmbajtje e sistemit sipas dispozitave të VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.



## **Modelimi dhe Dizajni i Bazave të të Dhënave**

Nga operatori ekonomik kërket që të kryhen këto aktivitete si më poshtë:

### **1.1. Dizajni Logjik**

- a. Dizajni i “High Level Diagram”
- b. Skema e gjithë diagramës konceptuale e modelit të të dhënave në të cilën paraqiten të gjithë të dhënat dhe marrëdhëniet mes tyre.
- c. Te zhvillohet duke përdorur teknikat ER ose UML.
- d. Modeli të transformohet në tabelë

### **1.2. Modelimi Konceptual**

- a. Te analizohen dhe modelohen duke përdorur diagramet ER ose UML.
- b. Këto duhet të përfshijnë tipare të ndryshme që do të shtjellohen më vonë, si semantika për marrëdhëniet opsionale, marrëdhëniet trinare, supertipet dhe nëntipet, etj.

### **1.3. Integrimi i Pamjes**

- a. Për të eliminuar mospërputhjet në model, këto pamje duhen të racionalizohen dhe konsolidohen në një pamje të vetme.
- b. Integrimi i pamjes të përdore dhe mjete të ER-it siç janë identifikimi i sinonimeve, agregacioni dhe gjeneralizimi

### **1.4. Transformimi i Modelit në Tabelë**


- a. Duke u bazuar në rregullat e paracaktuara, çdo entitet, së bashku me marrëdhëniet në mes tyre të transformohet në tabelë.

### **1.5. Dizajni Fizik**

- b. Për zgjidhjen e indekseve particionimin, dhe grumbullimin e të dhënave.
- c. Optimizimi i performancës.
- d. Integriteti i të dhënave, normalizimit të tabelave të krijuara.

### **1.6. Implementim, Monitorim dhe Modifikim**

- e. Kompletimi i databazës
- f. Testimi, monitorimi në arrihen kërkesat e performancës.
- g. Modifikime nëse nuk arrihen kërkesat e performancës.



Skema e databazës duhet të ndërtohet mbi parimin e zgjerueshmërisë që nënkupton që duhet të jetë fleksibile dhe të ketë mundësi të mëdha zgjerimi në të ardhmen. Lidhjet e tabelave duhet të jenë të qarta. Databaza duhet të komentohet dhe duhet të testohet. Skenarët e testimit duhet të përfshijnë elemente të ndryshme si psh. testimi për mundësinë e dyfishimit të të dhënave të njëjta (dy përdorues të njëjtë). Databaza duhet të mundësojë raportime të ndryshme, të sakta dhe të shpejta. Për këtë duhet të ndërtohet një bazë të dhënash që të ruajë gjithë këtë informacion në formë eficiente dhe të bëjë të mundur manipulimin dhe akses sa më të shpejtë të të dhënave.

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 5.1. Vendndodhja

## 5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës, dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 2 (dy) muaj nisur nga kjo datë dhe mirëmbajtja për 2 vjet pas implementimit.

## 6. RAPORTIMI

---

### 6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në original dhe 2 kopje:

- Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas një jave nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura. Kontraktori duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përfshirë anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 7 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 4 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

### 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

## 7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

---

Sistemi duhet të ketë mundësinë e komunikimit me sisteme të tjera ku pikë së pari hyn sistemi elektronik i gjendjes civile.

Gjithashtu sistemi do të jetë i hapur për bashkëpunime të vazhdueshme me sisteme të tjera të qeverisë qendrore dhe sisteme të tjera lokale në varësi të kërkesave.

## 8. GARANCIA

---

Garancia e sistemit, eKioskave dhe pajisjeve hardwerike, jo më pak se një vit.

## 9. MIRËMBAJTJA

Bazuar në VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, periudha e mirëmbajtjes do të jetë 2 vjet, ndërsa e ruajtjes së të dhënave për 4 vjet.

## 10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera pa TVSH
1	eKioska Pajisjet harduerike sipas specifikimeve teknike Softueri për realizimin e shërbimit	set	10		
2	Mirëmbajtje vjetore	vite	2		
	<b>Totali pa TVSH</b>				
	TVSH (20%)				
	<b>TOTALI ME TVSH (LEKË)</b>				

## 11.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i Fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12
1	Faza Përgatitore për sistemin Software (plani i punës, raporti fillestar)												
2	Ndërtimi/ Zhvillimi i sistemit software												
	Furnizimi i infrastrukturës hardware												
	Testimi dhe Integrimi i moduleve të sistemit dhe instalimi e konfigurimi në infrastrukturë												
	Përgatitja e mjedisit fizik për instalimin dhe testimin e kioskës												
3	Faza e testimit të sistemit												
4	Faza e trajnimit të përdoruesve												
5	Mirëmbajtja (24 muaj, në grafik shfaqen vetëm 10)												



## 12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

---

Çdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin e ndërtuar nga Kontraktori duhet t'i kalojë Përfituesit në format elektronik dhe në letër.

## 13.KËRKESAT FUNKSIONALE

---

Platforma duhet të zhvillohet duke pasur parasysh modelin e shumëgjuhësisë. Sistemi duhet t'i ketë 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) të hapura për ndryshim dhe përshtatje në varësi të planit dhe vendimit që do merret në fazat e para të implementimit. Sistemi duhet të dizajnohet në atë formë që duhet të mundësojë zgjerim në të ardhmen edhe për gjuhë të tjera.

Softueri duhet të jetë modular dhe duhet të ofrojë:

1. Lëshimin e certifikatës së lindjes (me mundësi opsionale që prindërit të kenë mundësinë e nxjerrjes për fëmijën nën 18 vjeç).
2. Lëshimin e ekstraktit të lindjes (me mundësi opsionale që prindërit të kenë mundësinë e nxjerrjes për fëmijën nën 18 vjeç).
3. Certifikata e martesës.
4. Certifikata e shtetësisë
5. Certifikata e vendbanimit

eKioska duhet të ofrojë mundësinë edhe të shërbimeve të tjera si:

- Mundësia e paraqitjes së kërkesës në formë elektronike
- Mundësia e paraqitjes së ankesës në formë elektronike.

Ankesat dhe kërkesat e qytetarëve duhet të kenë mundësi që automatikisht të dërgohen në një email që e përcakton bashkia.

Softueri duhet të mundësojë ndërlidhjen me sistemin qendror të të dhënave të regjistrimit civil. Kjo do të kryhet nga ana e operatorit ekonomik i cili është po ashtu i detyruar që gjatë paraqitjes së ofertës të përshkruajë edhe mënyrën se si do e realizojë.

Sistemi duhet të ruajë të dhënat e aplikuesit lokalisht dhe në data bazën qendrore të regjistrimit civil. Operatori ekonomik gjatë paraqitjes së ofertës duhet të përshkruajë realizimin. Ruajtja lokale nënkupton ruajtjen në serverin e Bashkisë.

Sistemi duhet të ofrojë raporte të ndryshme përfshirë raportet ditore, javore dhe mujore për përdorimin e kioskës nga qytetarët.

eKioska duhet të ofrojë komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin. Komunikimi duhet të specifikohet duke marrë parasysh edhe ndërfaqet e komunikimit.

Sistemi duhet të ketë modulën për autentifikim dhe autorizim përmes ID kartës. Qytetari me anë të ID kartës së vet do të ketë mundësinë që të autentifikohet me sukses. Të dhënat e autentifikimit poashtu duhet të ruhen në databazën lokale me mundësi shikimi prej aplikacionit menaxhues.

Databaza duhet të jetë në MS SQL ose në një teknologji ekuivalente.

Sistemi operativ duhet të jetë i licensuar dhe të ketë antivirus. Për shkakë sigurie sistemi është obligative që sistemi operativ të ketë antivirus.

eKioska duhet të jetë në gjendje të pranojë kërkesën, të pranojë pagesën dhe të shtyp certifikatën dhe dëshminë e ndërkaq të dhënat të merren në kohe reale nga sistemi i gjendjes civile. Për këtë operatori ekonomik duhet të jap përshkrimin teknik të realizimit. Detajet e këtij procesi i gjeni tek bllokdiagramet.

eKioska duhet të ruajë të dhënat në server për secilin qytetar që shërbehet nëpërmjet saj. Këtu duhet të përfshihen të dhënat personale por edhe të dhënat tjera si psh shërbimi i kërkuar, koha, foto e dokumentit të përdorur etj.

Të dhënat e qytetareve gjatë aplikimeve duhet të kenë mundësinë të lexohen përmes një softueri të veçantë që do instalohet në vendndodhjet e përcaktuara nga Bashkia. Ky softuer duhet të zhvillohet nga kompania fituese dhe duhet të:

- paraqesë të dhënat e LOG-ut.
- të ketë mundësinë e filtrimit.
- të ketë mundësinë e printimit dhe eksportimit në formatin excel.
- të ketë mundësinë e kontrollimit të gjendjes së kioskës përmes funksionit PING.
- të ketë mundësinë e kontrollimit të sasisë/numrit të letrave të ekioskës.
- të ketë mundësinë e regjistrimit të letrave.
- të ketë mundësinë e listimit dhe shikimit të ankesave dhe kërkesave të ardhura në nga ekioska në formë automatike.
- të ketë mundësinë e dërgimit në email të kërkesave dhe ankesave.
- mundësi të tjera që dalin gjatë fazës së analizës.

eKioska duhet të ketë çelës shtese për monedha i cili nuk duhet të jetë në miniaturë.

Hapja e eKioskes duhet të bëhet përmes dy çelësve që po ashtu nuk duhet të jenë në miniaturë.

Përdorimi i eKioskes duhet të ofrohet përmes ekranit të ndjeshëm në prekje me madhësi së paku 17inch.

Pranuesi i monedhave duhet të pranojë monedha dhe të kthejë kusur.

Duhet të detektojë monedhat e dëmtuara, monedhat falco dhe të kthejë kusurin. Duhet të jetë i mbyllur me çelës special dhe të ketë mundësinë e hapjes vetëm nga persona të autorizuar.

eKioska duhet të ketë mundësinë e zgjerimit të shërbimeve në të ardhmen.


Garancia e eKioskes dhe komponentëve përbërëse duhet të jetë 12 muaj. Brenda periudhës së garancisë, duhet të ofrohen trajnimet për stafin e bashkisë për përdorim të eKioskes dhe mbushjen me dokumente (për së paku 2 veta).

Mirëmbajtja e eKioskes dhe pjesëve përbërëse duhet të jetë 24 muaj.


Në rast të mosfunksionimit të eKioskes gjatë periudhës së garancisë kompania duhet të ndërhyjë brenda orarit të rënë dakord paraprakisht dhe duhet të dorëzojë raport të shkruar.

### 13.1. Funkcionalitete dhe Bllokskema

Kërkesat funksionale që kërkohet të realizojë sistemi që do ndërtohet janë paraqitur në bllokskemat e mëposhtme.



**Figura 1** Rrjedha e të dhënave dhe procesit që nga startimi i aplikacionit.



*Figura 2 Rrjedha e të dhënave dhe procesit që nga startimi i aplikacionit për kërkesë/ankesë.*

## 13.2. Karakteristikat teknike te platformes per kioska elektronike

### **KARAKTERISTIKA TE PERGJITHSHME**

#### **BAZA E TE DHENAVE**

Edhe pse baza e të dhënave e këtij projekti nuk planifikohet të jetë shumë e zgjeruar, megjithatë ajo duhet të jetë e strukturuar mirë dhe të ketë performancë të lartë në regjistrim, modifikim dhe selektim të të dhënave. Baza e të dhënave duhet të jetë e normalizuar dhe të ketë indeksim të mirë dhe të saktë.

Baza e të dhënave duhet të mundësojë ruajtje të të gjitha aplikimeve të bëra.

### **13.3. Profilizimi i përdoruesve**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të propozojë një platformë të përbërë nga ndërfaqet intuitive të arritshme nëpërmjet profileve të aksesit të lidhura me rolet e përdoruesve të ndryshëm, duke vënë në dispozicion të dhëna dhe funksionalitete të caktuara vetëm për përdorues specifike. Duhet të ofrohen, pra, logjika të përshtatshme autorizuese në mënyrë që të mundësojnë autorizimin e të gjitha ose një pjesë të aplikacioneve në dispozicion, në bazë të profilit specifik të konfiguruar për përdoruesin.

Aksesi në eKiosk do të mundësohet përmes autentikimit me kartë identiteti, ndërsa aksesi në sistemin menaxhues do të mundësohet përmes username dhe password. Aksesi brenda sistemit duhet të rregullohen në parimin e cituar më lart ku secila formë duhet të ketë autorizimin ose nivelin e privilegjeve për grupet respektive, rrjedhimisht për përdoruesit respektivë të grupeve.

Duke qenë se platforma planifikohet të ketë zgjerim është e nevojshme dhe domosdoshme që zgjidhja e ofruar të jetë dinamike për t'u përshtatur ndryshimeve në të ardhmen në formë fleksibile.

#### 13.4. Raporte

Raportet që duhet të gjenerojë sistemi që do ndërtohet mbi bazën e të dhënave hyrëse/dalëse të konsoliduara në kohë reale, do jenë:

- Raport ditor, javor dhe mujor mbi gjendjen e sistemit, numrin e certifikatave të lëshuara, të kategorizuara në bazë të llojit përkatës;
- Raport kohor me mundësi fleksibile të përzgjedhjes kohore;
- Raport i të dhënave *Raw Data*.
- Raport mbi kërkesat dhe ankesat e bëra.

### 14. KËRKESAT TEKNIKE

---

#### 14.1. Implikimet teknike që lidhen me zgjidhjen e propozuar:

- Sistemi do të mbulojë funksionalitete që aktualisht kryhen vetëm nga sistemi i gjendjes civile.
- Sistemi duhet të jetë desktop based, për të ofruar mundësi aksesimi nga kioska pa ndihmë shtesë (vetshërbim)
- Integrim me sisteme të tjera përmes XML API.
- Sistemi duhet të suportojë një mekanizëm të vecantë nativ për High Availability.

#### 14.2. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFRASTRUKTURËS HOSTUESE

Më poshtë po jepen specifikimet kryesore teknike të platformës infrastrukture , e cila duhet përdorur për hostimin e sistemit:

- Platformë me suport për të paktën katër nyje procesimi dhe ruajtje , në nje appliance të integruar. Nyja e procesimit dhe ruajtjes duhet të jetë e pajisur me të paktën 4C CPU, 64GB RAM, 200GB SSD cache, 5 x 1TB HDD storage, Network connection 4x 1GBE RJ45, ftohje e dedikuar me 2-3 ventilatore me rotor te dyfishte.
- Njësi ushqimi redundant afërsisht 2 x 1500W high-efficient, 220V AC50/60Hz
- Temperatura e punës 0° deri 40° C

#### 14.3. Kërkesat harduerike për furnizim

No.	Komponentë Components	Përshkrimi i detajuar Detail Description
1	Pjesa e procesimit/kompjuterit	Bordi kompjuterik kryesor/Industrial Mainboard: CPU: G2020 2.9 GHz; RAM: 8 GB; HDD: 500G; dhe lidhje me portë me pajisjet periferike eKiosk. Monitor me prekje 17 inç, rezistent ndaj ujit, Me transparence te lartë, me precizion dhe durueshmëri të lartë. Me porta USB kundër ndryshkut dhe kundër pluhurit, me Temperature operimi

-20 / +50C, rezolucion 1280x1024.

- 2 Printer lazer me format A4 dhe Kasetat e bojës  
Kërkesat minimale: Deri ne 45 ppm /A4 / 210 x 297 mm, 150 letra + 500 letra për sirtarët e printerit, shpejtësia e printimit të paktën 6.5 sekonda, deri në 1200 x 1200 dpi printim me cilësi rezolucioni. 512 MB memorje dhe procesor 400MHz CPU.  
Minimumi 2 Kasetat.
- 3 Printer Termal Etiketash  
Printer termal, Letra me thellësi 80 mm, Pika/rrjesht 576 pika, me Rezolucion 8, Shpejtesia e printimit 200 mm/s, Prerje automatike, gjerësia e printimit 72 mm, gjerësia e letrës 80 mm, trashësia e letrës 54-78 µm, WxDxH (mm).  
Gjetja e temperaturës së kokave te printimit: Termistor(matësi), Alarm njoftimi kur mbaron letra, Alarm kur ngec letra,  
Ndërfaqja: Portë seriale/USB
- 4 Makinë inteligjente automatike me monedha  
Pranuesi i monedhave dhe makineta.  
Të suportoje: 6 kanale monedhash.  
Me ndërfaqe: USB
- 5 Skaner i kartës së identitetit  
Të skanojë Barkode te ripit PDF417 dhe kode kartash MRZ.Me mundësi integrimi për të lexuar karta inteligjente.
- 6 Kamera e integruar e sigurisë  
Kamera e jashtme me kënd 360, me opsion shikueshmërie natën: Distanca IR 10m, Sensor CMOS-i, rezistent ndaj ujit, 5MP 1080P (full-HD)
- 7 Mbajtësja e jashtme  
Pjesa e jashtme ekioskës duhet të jetë e përbërë nga llamarina të paktën prej 4mm ne pjesën e përparme dhe pasme dhe të paktën 2mm në pjesen anësore. Duhet të ketë dimensione rreth: Lartësia: 190 cm, Thellessia: 100 cm dhe Gjeresia: 220cm, duhet te kete dere dhe te kete te instaluar celsin e sigurise dhe duhet te jete e organizuar në mënyrë të tillë qe te jete e aksesueshme edhe per personat qe perdorin karroce. E-kiosku dhe të gjitha pajisjet shoqëruese të vendosura/instaluar në te duhet të jenë të siguruar nga ndikimet ambientale (drita, lagështia, korozioni/oksidimi, temperaturat e ulëta dhe të larta, etj.), ndikimeve të jashtme fizike (qëndrueshmëria ndaj goditjeve, etj.). Pajisja duhet te ketë izolim me qellim te amortizimit te ndryshimeve te temperatures, si dhe të ketë pajisje ventiluese me termostat, ne menyre qe te aktivizohet mbi temperaturen 30 grade celsius.
- 8 UPS  
Duhet të ketë të instaluar(brënda) UPS me kapacitet më shumë se 1000 W.

### **14.3. Zgjerimi për të ardhmen**

Plaforma që kërkohet duhet të jetë një program i hapur që të parashikojë dhe sigurojë planifikimin, menaxhimin dhe zgjerimin e sigurt dhe të plotë në të ardhmen. Zgjerimi nuk duhet të ndikojë në performancë e as funksionalitet. Për zgjerim nuk duhet të ekzistojë nevoja që të rishkruhen pjesë të sistemit, e aq më pak i gjithi.

### **14.4. Kërkesa për dokumentimin e planit dhe implementimit të projektit**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një analizë tipike të proceseve të punës përmes diagramave UML me komentet dhe aktorët përkatës.
2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një përshkrim të detajuar të mënyrës së plotësimit të kërkesave funksionale e teknike, bashkëngjitur pamje printscreen.
3. Operatori Ekonomik duhet të jetë i gatshëm të demonstrojë sistemin, me kërkesë të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të Varësisë . Gatishmëria duhet të paraqitet përmes një dokumenti deklarate.
4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë planin e detajuar të skedular të projektit, me dorëzimet kyce, pikat ku mund të paraqitet risk I projektit dhe mënyra e adresimit.
5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë arkitekturën e sistemit me modulet përbërës, ndërfaqësimet, databazën.
6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë e testimeve për implementimin e projektit, përgjatë fazave të tij.
7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një plan të detajuar mirëmbajtjeje, me adresimin e çdo kërkesë apo problematike.
8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë planin e trajnimit, përmes aktiviteteve dhe dokumentacioni të qartë.

## **15. KËRKESAT FUNKSIONALE QË DUHET TË PLOTËSOJË INFRASTRUKTURA**

### **HOSTUESE SOFTWARE**

- Microsoft SQL Server 2012+ ose ekuivalente
- Sistem operativ Windows Server 2012+ ose ekuivalente
- .NET 4.5 ose ekuivalente

-Fund-